

28.03.2015

DORËHEQJA E ARBITRIT

Arbitrit mund të jep dorëheqje.

Arbitrit mund të jep dorëheqje me dëshirën e tij ose kur palët nuk pajtohen lidhur me përfundimin e mandatit, me kërkesën e njëres palë ose të ndonjë anëtari të tribunalit.

Gjykata vendos përfundimisht për përfundimin e mandatit të arbitrit.

Kundër vendimit të gjykatës nuk është e lejuar ankesa.

Sipas dispozitës së nenit 12 par 2 të LAK, nëse arbitrit jep dorëheqje ose palët pajtohen për përfundim të mandatit të arbitrit kjo nënkupton se ekziston njëra prej arsyeve të parapara me dispozitat me ligj.

zëvendësimi i arbitrit

arbitri zëvendësohet nëse mandati i tij përfundon sipas dispozitat e nenit 11 dhe 12 të LAK në rastet e tilla arbitri zëvendësohet me një arbitër tjetër, duke marr parasysh dispozitat për emërimin e arbitrit të LAK.

Nëse palët dakordohen për një procedurë tjetër, atëherë zbatohet marrëveshje e palëve.

PROCEDURAT E ARBITRAZHIT

Palët janë të barabarta në procedurë

Palët janë të barabarta në procedurë

Palëve duhet tu mundësohet ta paraqesin rastin e saj në secilën fazë të procedurës së arbitrazhit dhe të deklarojnë mbi kërkesat dhe faktet

Në kuadër të realizimit të barazisë së palëve, arbitrat kanë për detyrë të japin palëve sqarime në mënyrë që të bashku me palët të shqyrtojnë të gjitha faktet vendimtare dhe objektin e kontestit .

Palët, nëse nuk është në kundërshtim me dispozitat e LAK, mund të merren vesh mbi rregullat e procedurës që do të përmbahet tribunali i arbitrazhit, ose vetë do të caktojnë rregulla të posaçme, ligjin që do të aplikohet e kështu me radhë.

Nëse këto rregulla nuk janë caktuar me marrëveshje të palëve, dhe në mungesë të dispozitave përkatëse në këtë ligj, tribunali i arbitrazhit përcakton vet rregullat e arbitrazhit të një institucioni të arbitrazhit të përhershëm..

Pra, tribunali i arbitrazhit do ti caktojë vet rregullat e procedurës, ligjin që do ta aplikojë dhe do ta zgjedh mënyrën më të përshtatshme për nxjerrjen e provave të propozuara dhe për vërtetimin e gjendjes faktike.

Sipas nenit 16 . 2 të LAK, palët janë të lira në zgjedhjen e përfaqësuesve të tyre, të cilët do ti përfaqësojnë ato në procedurën e arbitrazhit.

Asnjë përfaqësues i autorizuar i palëve, nuk mund të përjashtohet nga procedura e arbitrazhit

Vendi i arbitrazhit

Në bazë të nenit 17.1 të LAK, nëse palët nuk janë pajtuar mbi vendin ku duhet të mbahet arbitrazhi, tribunali i arbitrazhit e cakton vendin e mbajtjes së arbitrazhit, duke marrë parasysh rrethanat e rastit konkret dhe përshtatshmërinë e vendit për palët dhe për tribunalin.

Pa cenuar paragrafin 1 të këtij neni, dhe nëse palët nuk janë marrë vesh ndryshe, tribunali i arbitrazhit mund të takohet dhe ti mbaj seancat në cilindo vend që e konsideron që e konsideron të përshtatshëm për përmbajtjen e dëgjimit të palëve, të dëshmitarëve, ose të ekspertëve, mbajtjen e konsultimeve ndërmjet anëtarëve të tribunalit të arbitrazhit dhe për shikimin e sendeve ose dokumenteve.

Fillim i procedurës së arbitrazhit

Nëse palët nuk janë pajtuar ndryshe, procedura e arbitrazhit lidhur me një kontest të caktuar fillon në ditën kur pranohet nga pala tjetër që kontesti ti nënshtrohet arbitrazhit.

Gjuha e Tribunalit të arbitrazhit

Menjëherë pas themelimit të tij, sipas nenit 19.1, Tribunali i arbitrazhit e përcakton gjuhën që do ta përdorë gjatë zhvillimit të procedurës së arbitrazhit.

Procedura mund të zhvillohet vetëm në një gjuhë, por mund të zhvillohet edhe në dy a më shumë gjuhë të tjera.

Tribunali i arbitrazhit do tu dërgojë palëve vendimet dhe parashtresat për të gjitha çështjet në gjuhën e caktuar nga tribunali i arbitrazhit.

Në gjuhën apo në gjuhët që do ti caktojë tribunali si gjuhë të tribunalit do të zhvillohen edhe seancat e dëgjimit.

Po sipas nenit 19. 2 të LAK, Tribunali i arbitrazhit mund të urdhërojë që të gjitha dokumenteve të dorëzuara gjatë procedurës së arbitrazhit tu bashkëngjiten një përkthim në gjuhën ose gjuhët për të cilat janë pajtuar palët ose të cilat i ka caktuar tribunali i arbitrazhit.

Tribunali i arbitrazhit i pranon vetëm përkthimet e bërë nga një përkthyes i certifikuar ose i aprovuar nga gjykata.

Sa ma shpejt të jetë e mundur Tribunali i Arbitrazhit do ta përcaktoj orarin e përkohshëm të arbitrazhit. Ky orar do t'iu dërgohet palëve në procedurë dhe institucionit të arbitrazhit. Me qëllim të efikasitetit të procedurës afatet e parapara me orar mund të shkurtohen në pajtim me palët, por varësisht nga rrethanat e rastit konkretë ato mund të zgjatën.

Nëse palët e kërkojnë Tribunali i Arbitrazhit mund të mbaj seancën për paraqitjen e provave nga dëshmitarët ekspertët si dhe argumentet me gojë.

Të gjitha provat e paraqitura nga njëra palë do ti komunikohen palës tjetër dhe institucionit të arbitrazhit.

Tribunali i arbitrazhit, në kërkesën ndonjë pale mund të lejoj një apo më shumë personave të tretë të bashkohen tribunalit. Që ti bashkohen një palë tribunalit duhet të jetë palë pjesëmarrëse në kontratë dhe në marrëveshjen e arbitrazhit.

PADIA

Padia duhet ti komunikohet me shkrim tribunalit të arbitrazhit. Tribunali i Arbitrazhit pa vonesë ia dërgon padinë palës së paditur.

Padia duhet të përmbaj përveç nëse palët janë pajtuar ndryshe këto të dhëna emrin dhe detajet e kontaktit të palëve.

Identifikimin e marrëveshjes së arbitrazhit me të cilin thirret.

Një përshkrim të shkurtër të mosmarrëveshjes.

Faktet në mbështetjen e padisë

Pikat kryesore të çështjes

Mjetet juridike të kërkuara

Bazën ligjore apo argumentet në mbështetje të padisë

Shumën e kontestit në kohën e paraqitjes së padisë përveç nëse padia nuk është e lidhur me ndonjë shumë.

Propozimin për numrin e arbitrave, gjuhën, vendin e arbitrazhit nëse palët nuk kanë rënë dakord për këto.

Nëse kërkohet një vendim nga tre arbitrat, emërimin e një arbitri dhe detajet e kontaktit të atij personi dhe hollësitë e kontaktimit të tij.

Në qoftë se emërohet një arbitër i vetëm propozimin lidhur me arbitrin për të emëruar.

Padisë duhet bashkangjitur një kopje të ndonjë kontrate apo instrumenti tjetër ligjor nga e cila ose në lidhje me të cilin lind mosmarrëveshja. Këto duhet dërguar në kopje të mjaftueshme për Tribunal dhe palët.

Padia gjithashtu duhet të shoqërohet nga të gjitha dokumentet dhe provat e tjera në të cilat mbështet paditësi të mbaj referenca për to.

Deklarata e mbrojtjes duhet të paraqitet me shkrim në Tribunalin e Arbitrazhit brenda një periudhe të përcaktuar nga arbitrazhi.

Deklarata e mbrojtjes do të përgjigjet për të gjitha të dhënat e paraqitura në padi dhe të shoqërohet me referenca në dokumente.

Kundërpadia

I padituri mund të parashtroj në fazat e mëvonshme të procedurës një kundërpadi me qëllim të kompensimit të ndërsjellët, me kusht që Tribunali i Arbitrazhit të ketë juridiksion për këtë.

Rregullat e padisë do të zbatohen edhe për kundërpadinë me qëllim të kompensimit të ndërsjellët.

Ndryshimet në padi ose në mbrojtje

Gjatë rrjedhjes së procedurës së arbitrazhit, pala mund ta ndryshoj ose ta plotësoj padinë ose mbrojtjen e vetë. Po ashtu mund të ndryshohet edhe kundërpadia me qëllim të kompensimit të ndërsjellët, përveç nëse Tribunali i Arbitrazhit e konsideron papërshtatshme lejimin e ndryshimit të padisë ose të mbrojtjes apo të kundërpadisë për shkak të vonesave apo paragjykimeve të palëve të tjera apo ndonjë rrethane tjetër.

Për ndryshimin dhe plotësimin e padisë dhe kundërpadisë çështja duhet të bien në juridiksionin e Tribunalit të Arbitrazhit

KOMPETENCAT E TRIBUNALIT TË ARBITRAZHIT

T A vendos mbi vlefshmërinë e marrëveshjes së arbitrazhit.

Për atë se a është kompetentë për zgjidhjen e kontestit i cili është parashtruar.

Klauzola e cila është pjesë e kontratës trajtohet si marrëveshje e veçantë dhe e pavarur prej kontratës.

Kundërshtimin, se T A nuk është kompetent pala duhet ta dorëzoj më së voni deri në momentin e dorëzimit të përgjigjes në padi.

Pala nuk mund të privohet nga e drejta e kundërshtimit për shkak se ka marrë pjesë në emërimi e një arbitri.

Kundërshtimi pse T A e ka tejkaluar kompetencën e vet duhet të paraqitet nga pala menjëherë pasi të vihet në dijeni për këtë.

T A mund ta pranoj një kundërshtim të paraqitur me vonesë nëse pala ka arsyetim të pranueshëm për këtë vonesë, kur është fjala për dy raste të përmendura më lartë.

Secila palë mund të kërkoj nga gjykata që ta shqyrtoj vendimin e T A lidhur me kompetencën e tij mbi kontestin përkatës.

Kërkesa duhet të dorëzohet në gjykatë brenda 30 ditëve prej ditës të pranimi të njoftimit me shkrim mbi vendimin.

Paraqitja e kërkesës nuk e ndalon T A që të vazhdoj me procedurën e A dhe të nxjerr vendim.

Çështja e kompetencës së arbitrazhit është e rregulluar edhe me konventën e Nju Jorkut.

T A i dorëzohen deklaratat me shkrim brenda afatit të përcaktuar me orarin e tribunalit.

Afatet e T A nuk mund të kalojnë më shumë se 45 ditë.

MASAT E PËRKOHSHME

T A mundet me kërkesën e njëres palë të caktoj masën e përkohshme. Masat e përkohshme i paraprin aktvendimit, por aktvendimi nuk duhet të ndikohet nga masat e përkohshme. Me masë të përkohshme arbitrazhi mund të urdhëroj

a) Mbajtjen ose rivendosjen e status quo në pritje të zgjidhjes së mosmarrëveshjes

- b) Të ndërmerr veprime që mund të ndalojnë shkaktimin e dëmit në të tashmen dhe të ardhshmen ose të mos cenohet procesi i arbitrazhit
- c) Të sigurohen mjetet për ruajtjen e pasurisë nga të cilat një vendim i mëvonshëm mund të përmbushet
- d) Të ruaj provat që mund të jenë relevante dhe materiale për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Pala që propozon masën e përkohshme duhet të demonstroj para T A se

1. Nëse nuk caktohet masa dëmi i shkaktuar do të ishte i pariparueshëm
2. Të dëshmoj me prova besueshmërinë e kërkesëpadisë dhe mundësit e arsyeshme që të ketë sukses në meritat e kontestit
3. T A mund ta ndryshoj, pezulloj apo ta ndërpres masën e përkohshme
4. TA mund të kërkojë nga pala propozuese e masës që të jep siguri se do të përmbushi dëmin nëse masa tregohet e pasuksesshme dhe me të i shkaktohet dëm palës tjetër.
5. T A do të kërkoj nga çdo palë që menjëherë ta njoftoj tribunalin e arbitrazhit për çdo ndryshim material në rrethanat mbi të cilat është caktuar masa e përkohshme.
6. Pala që ka propozuar për masën e përkohshme mund të ngarkohet me shpenzimet e zbatimit të masës së përkohshme, si dhe më dëmin e shkaktuar në qoftë se e humb kontestin
7. Pala mund që kërkesën për lëshimin e masës së përkohshme t'ia dërgoj edhe një gjykatës kompetente nëse do të konsiderohet e pamjaftueshme masa e përkohshme në marrëveshje të arbitrazhit, ose do të hiqet dorë nga marrëveshja e arbitrazhit .